



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 497/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaçi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.497/2019 e datës 20.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që një fletëvotim në kutinë e votimit 0914E/01R, të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ - QNR, që këtë fletëvotim ta largoj nga votat e vlefshme të publikuar me rezultatin përfundimtar të datës 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.497/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 19.11.2019, rreth orës 12:30 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave, konkretisht në kutinë e votimit 0914E/01R, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që në fletëvotimin e kontestuar nuk është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “Nisma”, mirëpo në shiritin e këtij subjekti politik në fund të vijës së anës së djathtë ku ndahen numrat për kandidatë është shënuar numri “1481417”, dhe po ashtu nuk është shënuar shenja “tik” as tek katrorët me numrat e dedikuar për kandidatë. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se mënyra se si është bërë ky shënjim i numrit e bënë të pavlefshëm fletëvotimin në kuptim të nenit 7 par.2 pika b) si dhe par.3 të këtij neni të Rregullës Zgjedhore 06/2013 të KQZ-së, pasi që ky veprim e bënë të paqartë qëllimin e votuesit andaj kërkojmë nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në, që ta shpallë të pavlefshëm këtë fletëvotim në kutinë 0914E/01R, dhe të njejtin të mos e përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të datës 07.11.2019. Si dëshmi për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur kopjen e fletëvotimit të kontestuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provës së bashkangjitur në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi ka paraqitur pretendimin se në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim në kutinë e votimit 0914E/01R të shpallet i pavlefshëm sepse bie në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se në kutinë e votimit 0914E/01R, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ekipi hetimor ka konstatuar se kutia e votimit 0914E/01R nuk ekziston si e tillë as si kuti e votimit dhe as si Vendvotim.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 497/2019 më datën 21.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.